

20140120313

L I G J PËR PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR PRONËSI INDUSTRIALE

Neni 1

Në Ligjin për pronësi industriale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 21/2009 dhe 24/11), pas nenit 8 shtohet titulli i ri dhe neni i ri 8-a, si vijojnë:

"Të drejta që dalin nga veprimtaria e inovacionit

Neni 8-a

(1) Zbulimi i krijuar në institucionin e arsimit sipëror, përkatësisht shkencor-hulumtues, si rezultat i veprimtarisë së inovacionit ose zhvillimore, të financuar nga mjetet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë në pajtim me Ligjin për veprimtari të inovacionit, i takon institucionit të arsimit sipëror, përkatësisht shkencor-hulumtues në të cilin është krijuar zbulimi, përveç nëse para se të fillojë projekti nuk është kontraktuar ndryshe.

(2) Nëse zbulimi i krijuar në institucionin, tërësisht financohet nga porositësi, e drejta e disponimit me zbulimin i takon porositësit, përveç nëse nuk është kontraktuar ndryshe. Porositësi nuk mund ta pengojë publikimin e zbulimit nga zbuluesi në mënyrë që nuk i pengon të drejtat e pronësisë intelektuale ose potencialin për komercializim të zbulimit.

(3) Nëse zbulimi nga paragrafi (1) i këtij neni është eksploatuar ekonomikisht, zbuluesi ka të drejtë për kompensim në shumë prej së paku 25% nga të hyrat e përgjithshme të realizuara, të cilat institucioni i ka realizuar me shfrytëzimin e tij komercial.

(4) Përqindja nga paragrafi (3) i këtij neni mund të ndryshohet me marrëveshje me shkrim ndërmjet zbuluesit dhe institucionit që ka realizuar të hyra, me ç'rast përqindja nuk mund të jetë më e vogël se përqindja e përcaktuar në paragrafin (3) të këtij neni.

(5) Kur ka më shumë pjesëmarrës në projekt, përkatësisht më shumë zbulues kanë krijuar zbulim, pjesëmarrja në fitim përcaktohet varësisht nga kontributi i tyre individual në krijimin e tij në pajtim me marrëveshjen."

Neni 2

Në nenin 33 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

"(3) Trashëgimtar juridik i zbuluesit konsiderohet edhe institucioni i arsimit sipëror, përkatësisht shkencor-hulumtues, në të cilin është krijuar zbulimi si rezultat i veprimtarisë së inovacionit ose zhvillimore, të financuar nga mjetet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, në pajtim me Ligjin për veprimtari të inovacionit, përveç nëse para se të fillojë projekti nuk është kontraktuar ndryshe."

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".